

SUCCESS STORY

Forcimi i integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në shoqëri



Foto: Të rinjtë nga komuniteti shqiptar dhe komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas në Gjakovë me certifikatat e ligjëratave për diversitetin

Gjithçka filloi me truAktiv, një program për të rinjtë i zbatuar nga Sbunker - që i bashkon të rinjtë rreth mendimit kritik, klubeve të leximit, diskutimeve dhe veprimeve të iniciuara nga të rinjtë në Prishtinë, por jo vetëm. "Së bashku mundemi" është një nga iniciativat e truAktiv, në Gjakovë udhëhequr nga Kristjan Lleshaj, anëtar i komunitetit shqiptar.

"Në fillim isha thjesht një pjesëmarrës gjatë diskutimeve rinore të organizuara nga truAktiv në qytetin tim. Unë dhe disa shokë vendosëm të aplikojmë në thirrjen e truAktiv me një nga idetë tona, që e kishim menduar për mjaft kohë. Duke qenë të vetëdijshëm për marginalizimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në Gjakovë, u ndjeva i detyruar të bëja diçka ndaj këtij realiteti", - thotë Kristjani.

Integritimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në shoqërinë kosovare është ende larg nga niveli i kënaqshëm. Sipas "Strategjisë për integritimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas", vetëm 32.4% prej tyre e kanë përfunduar shkollën fillore.

"Shumica e shokëve të mi nga ky komunitet e kanë braktisur shkollën. Unë dua t'i motivoj komunitetin rom, ashkalinj dhe egjiptas dhe të ndërmarr veprime. Kjo ishte një mundësi e mirë për ne që të bënim diçka; përmes idesë sonë të mbështetur nga truAktiv ne hodhëm hapin tonë të parë. Aktiviteti mblodhi anëtarë të komunitetit shqiptar, dhe komunitetit rom, ashkali, egjiptas në ligjërata rreth diversitetit dhe veprimeve të tjera që forcojnë integritimin dhe rrisin vlerën e multikulturalizmit".

Aktiviteti dy ditor u zhvillua në Gjakovë dhe mblodhi tridhjetë të rinj me prejardhje dhe etni të ndryshme, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së të rinjve për vlerën e diversitetit kulturor, promovimin e bashkëpunimit ndëretnik dhe parandalimin e konfliktit ndëretnik në komunitet. "Ky aktivitet ishte shumë i mirëpritur nga të dyja palët, nga komuniteti shqiptar dhe ai rom, ashkali dhe egjiptas" – thotë Kristjani. "Ne kemi nevojë për një zë që lobon për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rrit vetëdijen për rëndësinë e arsimit, veçanërisht në mesin e të rinjve që vijnë nga komuniteti."

Iniciativa "Së bashku mundemi" e motivoi Kristjanin dhe shokët e tij që të regjistronjë një organizatë joqeveritare në Gjakovë, të quajtur "Iniciativa". Ata janë të vendosur të forcojnë më tej të rinjtë, duke synuar integritimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë.

Kjo iniciativë është pjesë e programit truAktiv të zbatuar nga Sbunker me përkrahjen e Programit Angazhim për Barazi, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe i realizuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.